



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:153884

Datë: 16.01.2025

Numri i dokumentit: 06718004

Pml.nr.779/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Mejreme Memaj, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit T. Q., për shkak të veprës penale “Detyrimi”, nga neni 340, paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PM.nr.166/2018, datë 11.07.2024 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.502/2024, datë 03.10.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 15.01.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit T. Q., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PM.nr.166/2018, datë 11.07.2024 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.502/2024, datë 03.10.2024.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin e lartcekur, e ka shpallur fajtor të dënuarin T. Q., për shkak të veprës penale “Detyrimi”, nga neni 340, paragrafi 1 të KPRK-së dhe ndaj të njëjtit ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) vjetëve, në të cilin dënim do t’i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 13.09.2022 e tutje. Pala e dëmtuar – F. K., me përfaqësuesin e autorizuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest juridiko-civil. Është detyruar i dënuari që t’i paguaj shpenzimet

e procedurës penale aq sa do të jenë ato sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, kurse në emër të paushallit gjyqësor shumë prej katërqind (400) euro, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej pesëdhjetë (50) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Ndaj të dënuarit është caktuar paraburgimi deri sa ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Duke u bazuar në nenin 363, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), i dënuari është liruar nga akuza për shkak të veprave penale: “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 374, paragrafi 1 të KPRK-së dhe “Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet”, nga neni 235, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPRK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.502/2024, datë 03.10.2024, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të përfaqësuesit të palës së dëmtuar dhe të mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, avokati Granit Hadergjonaj, ku nga përmbajtja e kërkesës, rezulton se është paraqitur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe t’i anulojë aktgjykimet e kundërshtuara, ashtu që çështja penale të kthehet në rigjykim apo këto aktgjykime të ndryshohen, ndërsa i dënuari të lirohet nga akuza.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.446/2024, datë 31.12.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së dhe pasi i vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, gjeti se:

- kërkesa nuk është e bazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafët 2.2. dhe 2.7. lidhur me nenin 369, paragrafët 6, 7 dhe 8 të KPP-së, mirëpo nuk përcakton se ku qëndrojnë konkretisht këto shkelje të dispozitave ligjore. Përveç që nuk përcakton konkretisht se në çka konsistojnë këto shkelje ligjore, në kërkesë mbrojtësi i referohet disa aspekteve që nuk kanë të bëjnë fare me rastin konkret, por që i referohen ndonjë rasti tjetër që ka të bëjë me aksident të komunikacionit dhe gjithashtu, gjykatës së shkallës së parë i referohet si “Gjykata Themelore në Mitrovicë”. Përveç këtyre, kërkesa përmban edhe me pretendime të caktuara që kanë të bëjnë me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe në të paraqiten disa raste të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Po ashtu, në kërkesë, edhe pse në mënyrë të përgjithësuar, theksohet gjykata ka zbatuar ligjin penal në mënyrë të gabuar, në kuptim të shqiptimit të një dënimi në mënyrë të padrejtë, ngase nuk ka marrë për bazë moshën e të dënuarit, rrethanat familjare dhe sociale të të njëjtit, pasi që i njëjti është mbajtës i familjes, familjen e tij e mban duke u kujdesur për bagëti, si dhe sjelljen e të njëjtit pas konfliktit.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shikimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë konstatoi se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë nuk janë të përfshira me ndonjë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as me shkelje të ligjit penal në dëm të të dënuarit Taulant Qorri.

Siç u theksua edhe më parë, mbrojtësi i të dënuarit T. Q., në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë nuk ka specifikuar konkretisht se ku qëndrojnë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale që ndërlidhen me nenin 384, paragrafi 2, nën-paragrafët 2.2. dhe 2.7. lidhur me nenin 369, paragrafët 6, 7 dhe 8 të KPP-së, përveç se i përmend si të tilla. Sidoqoftë, Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka vërejtur që aktgjykimet e kundërshtuara të jenë përfshirë me shkelje të këtyre dispozitave të procedurës penale, në radhë të parë, për faktin se dispozitivi i aktgjyqimeve në fjalë është i qartë dhe nuk është kundërthënë, ndërsa në arsyetimet e tyre janë paraqitur arsye të mjaftueshme për të gjitha pikat, përkatësisht çështjet e rëndësishme, andaj edhe si të tilla, këto aktgjykime rezultojnë se janë përpiluar konform dispozitave përkatëse ligjore nga neni 369 dhe neni 404, paragrafi 1 të KPP-së. Përfundimet e gjykatave të instancave më të ulëta në lidhje me veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i dënuari T. Q., gjejnë mbështetje edhe në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, të cilat si të tilla shihet se janë analizuar dhe vlerësuar në mënyrën e duhur, ashtu siç është parashikuar në nenin 360, paragrafi 2 të KPP-së.

Në veçanti, është e rëndësishme që të theksohet se në arsyetimin e aktgjyqimit të gjykatës së shkallës së dytë janë paraqitur arsye të mjaftueshme dhe të qarta në lidhje me vlerësimin e pretendimeve thelbësore ankimore.

Gjykata Supreme e Kosovës e konsideron të pabazuar edhe pretendimin e mbrojtësit të të dënuarit T. Q., në lidhje me shkeljen e ligjit penal, pasi që gjykatat e instancave më të ulëta nuk kanë tejkaluar kompetencat e tyre ligjore me rastin e shqiptimit të dënimit me burgim. Sa i përket çështjes së shqiptimit të dënimit me të butë, Gjykata Supreme e Kosovës rikujton se sipas dispozitës së nenit 385, paragrafi 5 të KPP-së, kur është fjala për vendimin për dënimin, shkelje e ligjit penal konsiderohen vetëm rastet kur në marrjen e vendimit për dënimin, gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore. Ndërsa, në këtë çështje penale, gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar rrethanat përkatëse relevante, të dënuarit T. Q., i ka shqiptuar dënimin me burgim, brenda kufijve të parashikuara me ligj për veprën penale për të cilën i njëjti është shpallur fajtor, çka do të thotë se nuk janë tejkaluar kompetencat ligjore.

Përndryshe, edhe në këtë çështje penale, Gjykata Supreme e Kosovës rithekson se matja e dënimeve dhe vlerësimi i rrethanave përkatëse relevante është në kompetencë të gjykatës së

shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, varësisht nga rrethanat e rastit, ndërsa duke u bazuar në nenin 432, paragrafi 1 të KPP-së, këto pretendime në lidhje me shqiptimin e dënimeve më të buta, nuk mund të jetë arsye për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Në fund, duhet theksuar se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë përmban edhe pretendime të caktuara që ndërlidhen me gjendjen faktike, mirëpo Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se konform nenit 432, paragrafi 2 të KPP-së, ky mjet juridik nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike.

Në këtë mënyrë, nga arsyet e cekura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.779/2024, më 15.01.2025

Procesmbajtësi,
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,
Agim Maliqi